



Në vitin 1970, kur përfundoi ndërtimi, shtëpia iu dha në përdorim të përhershëm shoqatës së pensionistëve të Gostivarit. Aty kanë qenë të vendosur 21 familje pensionistë, ndërsa hapësirat përdhese kanë qenë për nevojat e shoqatës. Në vitin 1994 organet kompetente në vend këto shtëpi ua transferuan Fondit pensional. Në procese të posaçme gjyqësore shumica kanë arritur t'i kthejnë. Në Gostivar kjo nuk ndodhi. Kanë kaluar më shumë se 10 vite dhe ne ende mbetemi nëpër gjykata për të dëshmuar të vërtetën dhe të kërkojmë drejtësinë, thotë Xhelili


Kryetar i pensionistëve të Gostivarit, Nijazi Xhelili, flet për problemet e pensionistëve të Gostivarit, organizimin e tyre si dhe sfidat me të cilat ballafaqohen. Ai flet edhe për problemin në kthimin e shtëpisë së pensionistëve.

**Kryetari Xhelili, fillimisht na tregoni se cilat janë angazhimet kryesore dhe konkrete të shoqatës së pensionistëve të Gostivarit?**

Shoqata çdo vit përpilon program, i cili bazohet në kërkesat që janë në interes të pensionistëve. Sipas tij marrim pjesë në të gjitha manifestimet që i organizon LSHPM, si dhe në ato që i organizojnë shoqatat me të cilat realizojmë

Intervistë me Nijazi Xhelili, kryetar i SHP Gostivar

## Të na kthehet shtëpia e pensionistëve



bashkëpunim. Kur e theksoj këtë mendoj në tubimet me pensionistët që mbahen në shumë lokacione dhe qytete historike të vendit, por edhe vet jemi organizatorë të shumë ekskursioneve. Organizojmë edhe mbrëmje tradicionale të pensionistëve me vizitë masovike të më shumë se 400 pensionistëve. Në këto mbrëmje kemi program shumë nacional. Gjithashtu marrim pjesë në të gjitha manifestimet rajonale dhe republikane nga sfera e sportit, si dhe në revytë e këngëve, muzikës dhe valleve, ku shënojmë

rezultate të dukshme dhe marrim duartrokitje të fuqishme.

**Për njerëzit e gjeneratës së tretë zakonisht thonë se janë me shëndet të dobët. Çka bëni për zbutjen e këtyre gjendjeve?**

Kemi marrëveshje me të gjitha banjat në Maqedoni për qëndrim të pensionistëve anëtarë të shoqatës tonë me çmime të ulëta. Anëtarët tanë i stimulojmë edhe me nga 300 denarë në ditë për qëndrim në banja, ndërsa me shumë të këtillë partici-

pojmë vetëm për ata që kanë të ardhura të ulëta në familje. Së paku 50 pensionistë në vit shfrytëzojnë këtë ndihmë. Gjithashtu, rreth 30 pensionistëve me të ardhura të ulëta u ndajmë ndihmë të pakthyeshme në të holla, posaçërisht kur bëhet fjalë për shërim.

**Nga ajo që po thoni, vërehet se në shoqatën tuaj aplikoni kryesisht forma masovike të mbështetjes së pensionistëve. Si ja arrini në atë?**

Shoqata jonë funksionon në rajonin e tri komu-

nave: Gostivar, Mavrovë – Rostushë dhe Vrapçisht. Aty funksionojnë 23 degë me gjithsej 6.600 anëtarë. Realizojmë lidhje të ngushta me degët dhe 33 delegatët e tyre në kuvend. Mirë funksionon edhe Këshilli ekzekutiv i cili numëron 11 anëtarë dhe Këshilli mbikëqyrës me 5 anëtarë. Aktive janë edhe pesë komisionet e vazhdueshme. Realizojmë koordinim të vërtetë që jep rezultate të mira në punë.

**Më shumë se 10 vite në proces gjyqësor kërkoni të vërtetën për pronësinë e të ashtuquajturës "shtëpi të vjetër të pensionistëve" në Gostivar. A mund të na tregoni në pika të shkurta se si erdhi deri te ajo që të humbni pronësinë?**

Një parahistori të vogël. Në vitin 1970, kur përfundoi ndërtimi, shtëpia iu dha në përdorim të përhershëm shoqatës së pensionistëve të Gostivarit. Aty kanë qenë të vendosur 21 familje pensionistë, ndërsa hapësirat përdhese kanë qenë për nevojat e shoqatës. Në vitin 1994 organet kompetente në vend

këto shtëpi ua transferuan Fondit pensional. Në procese të posaçme gjyqësore shumica kanë arritur t'i kthejnë. Në Gostivar kjo nuk ndodhi. Kanë kaluar më shumë se 10 vite dhe ne ende mbetemi nëpër gjykata për të dëshmuar të vërtetën dhe të kërkojmë drejtësinë.

**Deri ku është puna?**

Ne posedojmë listë pronësore për pronësinë në emër të shoqatës prej 15 qershor 2012. Prandaj mbetemi të vendosur që të luftojmë për drejtësinë, me të cilën do të vërtetohen besimet dhe dëshmitë tona. Shpresojmë që të kemi rezultat pozitiv.

**Ju jeni kryetar i një prej shoqatave më aktive. Çka do të thoni për angazhimin tuaj personal?**

Në personalitetin e kryetarit të shoqatës janë edhe kryetari i Kuvendit dhe i Këshillit ekzekutiv. Unë në këtë pozitë gjendem prej 30 gusht 2008. Angazhohem për realizim të tërësishtëm të dispozitivave programore, për funksionimin e programeve dhe trupave, për bashkëpunimin me shumë shoqata të vendit, me LSHPM, ndërsa në Pogradec të Shqipërisë jam shpallur anëtar nderi. Edhe Shoqata edhe unë personalisht kemi marrë shumë falënderime dhe mirënjohje, që vërteton angazhimin tonë të suksesshëm dhe timin personal. Unë dhe ekipi im maksimalisht i kemi përkushtuar punës. Kështu do të vazhdojmë edhe në të ardhmen.

### SHP Ohër dhe Debërcë

## Shënohet solemnisht përvjetori i shoqatës

Të pranishmit i përshëndeti kryetari i LSHPM Dragi Argirovski, i cili shprehu fjalë miradije të shoqëruara me fakte për sukseset e SHP Ohër dhe Debërcë. Ai mes tjerash lavdëroi bashkëpunimin e shoqatës së Ohrit me pensionistët e Shqipërisë, Serbisë dhe paralajmëroi bashkëpunim me pensionistët nga Kosturi i Greqisë



stir – Tome Ilioski, Gazi Babë – Gjorge Andonov, Koçan – Gjorgi Serafimov dhe mysafirë të tjerë.

Manifestimi filloi me interpretimin dhe promovimin e Këngës solemne të SHP Ohër dhe Debërcë "Unë jam pensionist", të realizuar nga grupi i këngëtarëve të SHKA "Dallgi", me tekst të Risto Trajkoski, muzikë Mende Barakoski dhe aranzhman Dimitar Kitrozovski. Pastaj, para pensionistëve dhe mysafirëve të pranishëm, për sukseset dhe zhvillimin e SHP Ohër dhe Debërcë fjalim rasti kishte kryetari i KE Gjorgji Trpçevski. Mysafirëve dhe të pranishmëve në sallën e mbushur iu drejtua dhe i

përshëndeti kryetari i LSHPM Dragi Argirovski, i cili shprehu fjalë miradije të shoqëruara me fakte për sukseset e SHP Ohër dhe Debërcë. Ai mes tjerash lavdëroi bashkëpunimin e shoqatës së Ohrit me pensionistët e Shqipërisë, Serbisë dhe paralajmëroi bashkëpunim me pensionistët nga Kosturi i Greqisë.

Të pranishmit në manifestim i përshëndetën edhe zëvendës kryetari i Komunës së Ohrit, Angell Janev, kryetari i SHP Vranje, Miroslava Trajkoviç dhe kryetari i SHP "Solidarnost – Aerodrom", Dimitrija Bogatinovski. Pastaj, u promovua filmi dokumentar "Këta jemi ne

– SHP Ohër dhe Debërcë". Pas asaj u ndanë çmime dhe mirënjohje për personat e theksuar që kanë dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e SHP Ohër dhe Debërcë. Për kontribut të veçantë në zhvillimin e LSHPM dhe bashkëpunimin me SHP Ohër – Debërcë, kryetari të LSHPM Dragi Argirovski i është dhuruar KARTË. Për angazhim të përkushtuar dhe rezultate të mahnitshme në sport dhe kulturë u janë dhuruar Pllaketa udhëheqësit artistik të SHKA "Dallgi" Risto Trajkoski, sportistes me shtatë medalje të arta të fituara, Bllagica Markuleska, ndërsa mirënjohje të posaçme fitoi edhe Lolita Gjoneska, e punësuar në shërbimin profesional të shoqatës. Mirënjohje ju ndanë edhe Ruzha Baleska, Ristana Mojskoska dhe Millanka Pandelleska, ndërsa Falënderime morën kryetarët e shoqatave nga Vranja, Pogradeci, "Solidarnost-Aerodrom" dhe Gazi Baba nga Shkupi, Manastiri, Prilepi, Koçani dhe Struga. Në rastin solemn, marrëveshje bashkëpunimi u nënshkrua mes kryetarëve të SHP Ohër dhe Debërcë dhe Vranjës nga Serbia.



## Ivanov pranoi në takim delegacionin nga LSHPM

Kryetari i Republikës së Maqedonisë, Gjorge Ivanov më 21 qershor ka pranuar përfaqësuesit e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë në përbërje të Dragi Argirovski, kryetari i LSHPM, Besnik Pocesta, kryetari Kuvendit, Salltir Karovski, nënkryetar i KE të LSHPM dhe Stanka Trajkova sekretare e KE të LSHPM, të cilët e kanë informuar kryetarin Ivanov për sfidat me të cilat ballafaqohen, si dhe për rezultatet e arritura në relacion të përmirësimit të standardit jetësor të pensionistëve në Republikën e Maqedonisë. Kryetari i Maqedonisë ka shprehur mbështetjen për aktivitetet e pensionistëve

si në kuadër të shtëpisë dhe familjes, si dhe në bashkësi me të zgjeruar, dhe ka theksuar se përmes pjesëmarrjes së tyre në shumë iniciativa, me njohuritë e tyre, përvojën dhe kapacitetin intelektual japin kontribut të jashtëzakonshëm në fushën shoqërore. Në takim, kryetari i Lidhjes, Dragi Argirovski i ndau pllaketë kryetarit Ivanov, si shenjë falënderimi për mbështetjen në aktivitetet dhe afirmim të statusit të pensionistëve në Republikën e Maqedonisë, si dhe Monografinë "Aktivitetet e pensionistëve për respekt" të përgatitur me rastin e 70 vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni.